



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 11
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 204
Prishtinë, më 14 shkurt 2018, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Enver Hoti, Miljana Nikoliq, Fatmire Kollçaku-Mulhaxha, Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Flora Brovina, Bekim Haxhiu, Time Kadrijaj dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Faton Topalli.

Pjesëmarrës të tjerë: Artan Murati – KDI dhe mediat.

Stafi mbështetës i komisionit: Shprese Haxhijaj, koordinatore e komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më: 17.01.2018 dhe 24.01.2018;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për gjak dhe përbërës të gjakut;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 17.01.2018 dhe 24.01.2018

Kryetarja konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale i miratoi, pa vërejtje, procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 17.01.2018 dhe 24.01.2018.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për gjak dhe përbërës të gjakut

Kryetarja: Kalojmë të shqyrtimi dhe miratimi në parim i projektligjit për gjak dhe përbërës të gjakut. Ne, siç e dini, kemi pasur ligjin për kontroll të gjakut dhe produktet e tij, i cili është prej vitit 2008. Projektligji rregullon dhurimin, grumbullimin, testimin, përpunimin, kontrollin e cilësisë ruajtjen, menaxhimin, si dhe shpërndarjen e gjakut dhe përbërësve të tij. Gjatë monitorimit të ligjit për shëndetësi nga spitalet private kemi pasur vërejte, sidomos për transfuzionin e gjakut. Ky projektligj është shumë i nevojshëm, kështu që rregullimi i kësaj fushe është i rëndësishëm në qëllim të adresimit të objektivave strategjike të sektori të shëndetësisë, prandaj në parim ne, si komision, duhet të miratojmë këtë projektligj. Mandej gjatë leximit të dytë e plotësojmë aty ku ka nevojë.

Naser Rugova: Unë e kam shikuar teknikat juridike, struktura e ligjit dhe ka qenë e nevojshme një plotësim, ndryshim i ligjit. Ka qenë edhe kërkesë e objektivave për integritet evropian në Kosovë, që dhurimi, ruajtja e gjakut për përbërësit të tij të rregullohet me ligj. Ne duhet në parim t'ia lejojmë dritën e gjelbër këtë ligj për procedim të mëtutjeshëm, kurse për specifika të tjera kemi kohë gjatë fazës së amendamenteve. Për mua është ligj i punuar mirë dhe mendoj që në parim duhet ta përkrahim këtë projektligj.

Haxhi Avdyli: Edhe unë konsideroj se është një ligj i nevojshëm dhe si punëtor shëndetësor që kam punuar në sektorin publik dhe privat, ka qenë hendikep për klinikat private, të cilat s'kanë mundur edhe në rastet kur është rrezikuar jeta e pacientit. Pra, s'kanë pasur mundësi që të kenë transfuzionin e tyre të gjakut. Ka pasur probleme të vazhdueshëm, procedura të gjata, vështirësi transporti, ruajtja dhe në këtë rast kemi rrezikuar edhe jetën e pacientëve shpesh herë. Unë jam që të miratojmë në parim projektligjin. Ne duhet ta pajtohemi të rregullohet puna e gjakut në aspektin komercial sepse nuk e di sa është rregulluar me ligj që puna e gjakut mos me qenë përfitim për klinika private sepse klinikat private mundohen me pasur të hyra. Por si produkt njerëzor i cili në shumtën e rasteve i jepet në formë donacioni apo si dhurues në formë dhurimi që të shikohet mundësia që të mos shitet kjo, sepse shpesh herë ka ndodhur që edhe në klinika shtetërore janë shitur. Unë mendoj që këtu duhet të kemi kujdes, gjaku duhet të konsiderohet si produkt njerëzor sepse në shumicën e rasteve është përdorë si siguri, e jo si mjet për përfitime.

Bekim Haxhiu: Është një Projektligj i domosdoshëm, mirë që ka ardhur në shqyrtim dhe mendoj që ndoshta për aq sa kemi kohë duhet ta trajtojmë ose të punojmë dhe mendoj që duhet përfundoj sa më shpejt sepse është në interes të qytetarit dhe pacientëve. Është e vërtetë që ka pasur dukuri negative sa i përket trajtimit të gjakut dhe produktit të tij. Një prej elementeve që ne duhet paraparë si masë ndëshkuese është edhe ndalimin e tregimit të gjakut dhe produktit të tij. Mendoj që duhet një bashkëpunim realisht më i ngushtë me ministrin e Shëndetësisë që të

realizojmë edhe një vizitë, një grup punues që të shohim nga afër ndonjë vend që e ka këtë legjislacion të harmonizuar me legjislacionin e BE-së. Unë mendoj që duhet të fokusohemi dhe që të përshpejtojmë punën.

Time Kadrijaj: Ky është një ligj i rëndësishëm dhe duhet të miratohet në parim, por edhe unë pajtohem për një vizitë studimore kudo qoftë, që kanë një ligj të tillë me shikuar praktikisht sepse vërtet na ka ndodhur me shumë projektligje të tjera ku kemi marrë praktika të mira e kemi pasur më të lehtë gjatë fazës së amendamentimit të projektligjit. Të mbajmë një dëgjim publik dhe të shqyrtojmë me një intensitet të shtuar dhe të miratojmë sa më parë dhe ligji të fillojë t'i japë efektet e tij të para në praktikë.

Flora Brovina: Ne kemi aprovuar një ligj që quhet ligji për urgjencën e që nuk po aplikohet, shumë keq sepse para disa ditëve është bërë promovimi i nr. 112, e që vlen edhe për urgjencën në përgjithësi, por shëndetësia nuk ishte askund. Prandaj kjo lidhet edhe me këtë projektligjin e gjakut dhe përbërësit e tij, është shumë e nevojshme për shkak të mungesës të mjaftueshme të kulturës për dhënien e gjakut dhe kjo mungesë dihet si mungesa e edukatës së dhurimit të gjakut të masat e ndryshme të gjakut. Pra, neve na shpëton policia dhe ushtria që kemi sadopak gjak sepse donatorët janë të paktë, pse ka qenë në dilemë që të kontrollohet mirë dhënia e gjakut të këtë qendër sepse jo vetëm për shkak të ambulancave private, por të donatorëve që kanë shitur gjakun, por më duket që po bëhet një keqpërdorim edhe të transfuzioni! Prandaj mendoj që duhet të përqendrohemi pak më mirë në prodhimin e produkteve të tjera të gjakut të cilat kanë munguar në Kosovë.

Enver Hoti: Është mirë që po bëhet projektligji për gjak dhe përbërës të gjakut ky projektligj përfshin një game të gjerë që e rregullon në këtë rast, i rregullon tri fusha shëndetësinë publike, shëndetësinë private dhe partneritetin publiko-privat! Edhe unë mendoj që duhet të punojmë bashkërisht. Shumica prej jush jeni ekspertë të fushës të shëndetësisë dhe sigurisht duhet të japim kontributin gjatë amendamentimit të tij. Ne e përkrahim që ta miratojmë në parim.

Kryetarja: Pas diskutimeve, komisioni miratoi në parim projektligjit për gjak dhe përbërës të gjakut dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projektligji për gjak dhe përbërës të gjakut.

4. Të ndryshme

Kryetarja: Unë kam një kërkesë që neve, si deputetë, kemi marrë njoftimin se Kryesia e Kuvendit ka vendosur që të mos realizohen vizita zyrtare deri në fund të muajit mars. Andaj duke u nisur edhe nga kërkesat tuaja edhe nevojës si komision për marrje të praktikave të mira për projektligjet që i kemi në procedurë dhe t'i përfundojmë sa më parë. Unë kam një propozim që të bëjmë një kërkesë për Kryesi për realizimin e një vizitë në Shqipëri, jemi afër, po në rast se kemi ndonjë seancë të jashtëzakonshme mund të kthehemi brenda ditës. Të realizojmë një vizitë zyrtare në Shqipëri të realizojmë takim me komisionin homolog dhe vizitë në Qendrën Spitalore “Nena Terezë” dhe të njëjtën kohë të diskutojmë për projektligjin që tani e kemi në diskutim, njëkohësisht të marrim praktika të mira edhe për ligjin për ndërmarrjet sociale.

Kryetarja: Të gjithë ju keni pranuar një shkresë nga prof. dr. Arsim Morina ushtrues detyrës - drejtori i klinikës së neurokirurgjisë. Ne e kemi vizituar këtë klinikë dhe nga afër kemi njohur me problemet e tyre dhe nevojën edhe për një sallë të operacionit. Mirëpo përsëri përmes një shkresë kanë kërkuar mbështetjen tonë që të ju ndihmojmë apo t'i përkrahim në kërkesën e tyre për sallë. Ne, si komision, e vetmja mënyrë të ndikojmë është të pyesim ministrin e Shëndetësisë dhe të pyesim se si janë planet tyre dhe kur do të përmbushin këtë kërkesë.

Haxhi Avdyli: Me lejoni t'ju falënderoj, juve si kryetare dhe komisionin se njërin nga vizitat e para e kemi realizuar në klinikën e neurokirurgjisë, si një klinikë e lënë anash. Shpesh herë krijohet përshtypja në opinion se i jepet prioritet i madhe kardiokirurgjisë, po ashtu edhe ajo është me rëndësi për qytetarët! Mirëpo edhe lëmin e neurokirurgjisë që ka të bëjë me operacionet më të ndërlikuara dhe të vështira të cilat ndodhin në tru edhe në kurriz. Qe 17 vjet kjo klinikë ka mbetur e anashkaluar. Ka një staf shumë të përgatitur, diku mbi 12 neurokirurgë të cilët punojnë në vazhdimësi dhe kryejnë operacione shumë të vështira dhe të cilat kanë një kosto shumë të lartë. Në këtë klinikë shërbimet janë kryer në vazhdimësi, mirëpo asnjëherë përkrahje s'ka pasur, vetëm një shembull Shqipëria ka tri kate një ndërtesë për neurokirurgji, ne, në Prishtinë, që nga pas lufta e kemi një repart me shtatë dhoma dhe një sallë të operacionit. Prandaj unë kisha pasur dëshirë që t'i japim prioritet edhe fushës së neurologjisë ka edhe lëmi të tjera që kërkojnë një prioritet. Mundësia është që të ndërtohet një sallë e re për neurologjinë sepse edhe do t'i ndihmonte zhvillimin e kësaj fushe edhe pacientet nuk do të shkojnë për trajtim jashtë vendit. Pra, unë po mendoj që duhet një zgjedhje për këtë çështje zgjidhja është e lehtë vetëm duhet një menaxhim me mirë i hapësirave apo riorganizim i klinikave nëpër hapësira të QKUK-së. Çështje tjetër shqetësuese është edhe mungesa e insulinës. Pra, kemi një numër të madh të pacientëve që janë me diabet dhe janë duke i vuajtur pasojat për mungesa të insulinës. Andaj si komision këtë çështje duhet të trajtojmë dhe të kërkojmë informatë nga ministri i MSH-se se çka po ndodhë me furnizimin me insulinë.

Besa Baftiu: Unë kam marr një informatë nga MSH se vonesat janë si shkak i procedurave të tenderimit. Sipas tyre javën e ardhshme do të furnizohen me insulinë nëse nuk ankohen operatorët ekonomik. Kjo në vazhdimësi po ndodh dhe viktimë po janë pacientët.

Fatmire Kollçaku - Mulhaxha: Ne, si komision, e kemi obligim se kjo nuk është vetëm thjesht ndërhyrje e komisionit në punën e QKUK-së. Po faktikisht është politikat dhe strategjitë se çka është prioritet në shëndetësi. Unë mendoj se kardiokirurgjia dhe neurokirurgjia është dashtë të jenë prioritet në shëndetësi, sidomos duke pasur parasysh kohëzgjatjen e operacionit dhe infeksionet interaspitalore. Problematika është pas operacionit ambientet jo të mira të papastra edhe mundësit për infeksion janë shumë të mëdha. Pra, unë mendoj që këtë problem ne duhet si komision ta marrim shumë seriozisht, sepse është problem madhor që në një farë forme kush nuk ka nevojë një intervenim tillë, mund edhe të mos jetë për të. Pra, ne duhet gjejmë mënyrën për zgjedhjen e këtij problemi.

Bekim Haxhiu: Mendoj që këto probleme të hapësirave të klinikave duhet diskutuar bashkë me drejtorin. Por para se me kaluar në atë diskutim duhet riaktivizuar çështjen e QKUK-së, jo SHSKUK-së. Sepse QKUK-ja është shuar kundërligjshëm dhe duhet ri aktualizuar si çështje sepse edhe me ligj edhe me statut është e paraparë funksionimi i QKUK-së ashtu siç funksionon qendra e stomatologjisë, si njësi përbërës SHSKUK dhe spitaleve rajonale, realisht është shqetësuese mënyra se si janë menaxhuar hapësirat dhe rëndësia e tyre e prioriteteve që është dhënë në mes atij dhe të investimeve që janë bërë. Unë kam qenë kategorik se mjetet e kredisë së bankës së Austrisë të investohen në sallat operative, pra të krijohen kushte më të mira për punë.

Është shqetësuese klinika e vaskulare, gjithë atë hapësirë që e kanë dhe lista e pritjes më të shkurtën e ka 2 deri 5 vjet dhe aty ka pak gatishmëri nëse shikojmë numrin e operacioneve që bëjnë brenda ditës. Dhe në këtë rast një kat lart t'i lirohet klinikës së neurokirurgjisë dhe vaskularja të transferohet të ortopedia apo intensivja se edhe ashtu janë duke punuar shumë pak dhe t'ju jepet hapësirë atyre që janë duke punuar dhe po kërkojnë hapësirë për punë. Dhe kjo është më rëndësi që ne me diskutuar bashkë me drejtorin dhe me ministrin e Shëndetësisë.

Kryetarja: Po besoj se të gjithë keni pranuar ftesën për pjesëmarrje në tryezë të rrumbullaket që organizohet nga MSH së bashku me komisionin tonë dhe mbështetjen e UNICEF-it. Tema: Zbatimi i ligjit, të ushqyerit me qumësht gjiri dhe kontributi në zhvillimin e fëmijëve.

Kryetarja: Po ashtu kemi një kërkesë nga Instituti i mjekësisë se punës në Obiliq për një takim me komisionin. Me qëllim që të na njoftojnë me problemet që po përballen, si dhe me statusin e tyre ligjor.

Komisioni, pas diskutimeve rreth kërkesës për realizim takimit, vendosi që kryetarja e komisionit të realizojë takim me institutin e mjekësisë së punës në Obiliq dhe në Gjakovë. T'i marrë shqetësimet e tyre dhe të ftohen kur do të diskutohen ndryshimet e ligjit të shëndetësisë.

Ju faleminderit për pjesëmarrje!

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit

Kryetarja e komisionit,

Besa BAFTIU